

Anketa e Buxhetit të Njësive Ekonomike Familjare, 2023*

Tiranë, më 04 Tetor 2024: Në vitin 2023, shpenzimet mesatare mujore për konsum për një Njësi Ekonomike Familjare, e përbërë mesatarisht nga 3,7 persona, vlerësohen me 91.675 lekë. Ky tregues është 3,7 % më i lartë se në vitin 2022. Shpenzimet gjithsej për konsum janë rreth 68.4 miliardë lekë në muaj.

Në vitin 2023, grupi me rritjen më të lartë të shpenzimeve mujore është “të tjera mallra dhe shërbime”, me 6,2 %, krahasuar me vitin 2022, ndjekur nga grupet:

- “pije alkoolike dhe duhan” 5,6%;
- “mobilim dhe mirëmbajtje e zakonshme e banesës” 5,1%.

Sipas strukturës së shpenzimeve mesatare mujore për konsum grupet kryesore janë (Tab.1):

- Grupi “ushqime dhe pije jo-alkoolike”, me një vlerë mesatare mujore të shpenzimeve prej 36.349 lekë, i cili zë një peshë prej 39,6 % në buxhetin familjar. Nëngrupet me peshën më të madhe në shpenzimet për ushqim janë:
 - “mish dhe nënprodukte” me 18,5%;
 - “bukë dhe drithëra” me 16,5 %;
 - “perime” me 16,0%.
- Grupi i “shpenzime për banesën, ujë, energji elektrike dhe qira e paguar” me një vlerë mesatare mujore prej 8.904 lekë, përbën 9,7 % të totalit të buxhetit.
- Grupi “restorante dhe hotele”, me një vlerë mesatare mujore të shpenzimeve prej 6.755 lekë, zë 7,4 % të buxhetit gjithsej.

Për publikim 04/10/2024

**Diferenca midis disa treguesve të anketës së Buxhetit të Njësive Ekonomike Familjare (ABNjEF) dhe atyre të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023 lind sepse ABNjEF është e kalibruar duke përdorur komizën e kampionimit të popullsisë nga Censi i vitit 2011. Në vitet në vijim komiza e kampionimit dhe kalibrimi i rezultateve të anketës do të bazohet në Censin e Popullsisë dhe Banesave, 2023.*

Vijon

Tab.1 Struktura e shpenzimeve mesatare mujore për konsum të NjEF, 2022 – 2023

Grupet kryesore të konsumit	ABF 2022	ABF 2023
	%	%
Ushqim dhe pije jo-alkoolike	39,7	39,6
Pije alkoolike dhe duhan	4,2	4,2
Veshje dhe këpucë	5,0	5,0
Shpenzime për banesën, ujë, energji elektrike dhe qira e paguar	9,8	9,7
Mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje e zakonshme e banesës	6,5	6,6
Shëndet	4,3	4,3
Transport	6,9	6,8
Komunikim	3,9	3,8
Argëtim dhe kulturë	2,7	2,6
Arsim	3,5	3,5
Restorante dhe hotele	7,3	7,4
Të tjera mallra dhe shërbime	6,3	6,5
Gjithsej	100,0	100,0

Në vitin 2023, shpenzimet për grupin **“të tjera mallra dhe shërbime”**, u rritën me 6,2 %. Kjo rritje erdhi kryesisht nga shpenzimet më të larta për **“higjienë personale”**, **“trajttime estetike”** dhe **“shërbime parukerie dhe berber”**. Si pasojë, pesha e këtij grupi në shpenzimet mesatare mujore të NjEF është rritur.

Shpenzimet për **“pije alkoolike dhe duhan”** u rritën me 5,6 %, krahasuar me vitin 2022, kryesisht për shkak të rritjes së shpenzimeve për **“pije alkoolike”** me rreth 8 %.

Shpenzimet për **“mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje të banesës”** u rritën me 5,1 %, krahasuar me vitin e kaluar. Kjo rritje erdhi nga shpenzimet më të larta për **“shërbime periodike”** (pastues, kopshtar, etj.), **“blerje pajisjesh për gatim”** dhe **“riparime të ndryshme në familje”**.

Shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas qarqeve, 2023


Në vitin 2023, njësitë ekonomike familjare të qarkut Tiranë, shpenzojnë më shumë për konsum, mesatarisht 108.098 lekë në muaj. Qarqet e tjera me shpenzime të larta mujore për konsum janë:

- Korça: 91.034 lekë
- Durrësi: 89.561 lekë

Qarqet me shpenzimet mesatare më të ulëta mujore për konsum janë:

- Kukësi: 73.225 lekë
- Dibra: 74.479 lekë

Fig.1 Shpenzimet mesatare mujore për konsum të NjEF sipas qarqeve, 2023



Metodologjia

Anketa e Buxhetit të Njësive Ekonomike Familjare është një vrojtim statistikor që kryhet pranë njësive ekonomike familjare (NjEF) dhe jep një panoramë të situatës socio-ekonomike të NjEF në Shqipëri. Rezultatet e kësaj ankete përdoren gjithashtu për përditësimin e Indeksit të Çmimeve të Konsumit dhe llogaritjen e Konsumit Final të NjEF si një agregat i rëndësishëm i PBB me metodën e shpenzimeve. Anketa e Buxhetit të NjEF-ve u krye për herë të parë në vitet 1999-2000 dhe ishte përfaqësuese vetëm për zonat urbane, për të vazhduar më pas në vitet 2006-2007, 2008-2009 dhe që nga viti 2014 e vazhdueshme. Nga viti 2006-2007 anketa është gjithë-përfshirëse për të gjithë territorin e Shqipërisë duke përfshirë zonat urbane dhe rurale si dhe me përfaqësim në nivel qarku.

Në vitin 2023, kampioni i anketës së buxhetit të familjes ishte 10.452 NjEF. Për shkak të Censit të Popullsisë dhe Banesave puna në terren u ndërpre gjatë periudhës Shtator – Nëntor ku 2.608 NjEF nuk u intervistuan. Kështu, vrojtimi u krye përgjatë një periudhë 9-mujore me një kampion prej 7.844 NjEF. Në përfundim të vrojtimit u intervistuan 5.525 NjEF të shpërndara në mënyrë uniforme në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Shkalla e përgjigjes së NjEF, e llogaritur si raport i numrit të NjEF që kanë plotësuar anketën ndaj numrit të NjEF të zgjedhura për t'u intervistuar gjatë vitit 2023, shprehur në përqindje rezultoi 70,4 %.

Zgjedhja e kampionit bëhet sipas një procedure dy-hapëshe. Njësitë e hapit të parë (PSU) janë zonat e Censit të homogjenizuara, me probabilitet përpjesëtimor me madhësinë e zonës së Censit. Në hapin e dytë, brenda secilës prej zonave të zgjedhura në hapin e parë, zgjidhen sipas metodës së zgjedhjes sistematike me probabilitet të barabartë një numër fiksis prej 12 NjEF. Zgjedhja në të dyja hapat është bërë në mënyrë të rastësishme duke siguruar një përfaqësim edhe në nivel qarku. Totali i NjEF të kampionuara u nda në 4 nën-kampione tre-mujore të cilët u shpërndanë gjeografikisht në mënyrë homogjene gjatë gjithë vitit, për të bërë të mundur pasqyrimin e ndryshimeve stinore. Si rrjedhim, janë anketuar çdo muaj rreth 871 NjEF të shpërndara njëtrajtësisht në të gjitha zonat e zgjedhura, për të siguruar përfaqësimin e çdo zone në të gjithë muajt e vitit.

Mbledhja e të dhënave bazohet në dy mënyra të ndryshme të mbledhjes së informacionit:

- Plotësimi i një ditari nga ana e NjEF ku regjistrohen shpenzimet për blerje produktesh/shërbimesh të konsumit të gjerë si dhe, sa herë që plotësohen kushtet, plotësimi i një ditari të veçantë për autokonsum ku familja regjistron vetëm produktet e

prodhuara dhe të konsumuara gjatë ditëve të referencës, vlerësuar me çmimin që do të kishte paguar për t'i blerë në dyqanin më të afërt;

- Kryerja e një interviste direkte nga anketuesit nëpërmjet një pyetësi ku përfshihen pyetje mbi shpenzimet me vlerë më të madhe dhe me frekuencë blerjeje më të rrallë, të grupuara dhe të ndara sipas temave të veçanta, Në të njëjtin pyetësor janë përfshirë edhe pyetjet mbi të dhënat socio-demografike të anëtarëve të NjEF që do të shërbejnë gjatë analizës së buxhetit familjar sipas tipologjive të NjEF;
- Periudha e referencës së mbledhjes së të dhënave për studimin e vitit 2023 ku ditari dhe fletorja e vetë-konsumit mbledh të dhëna me periudhë reference 1 javë për të gjithë kampionin.

Përkufizime:

Shpenzimet për konsum të NjEF përfshijnë çdo lloj blerjeje produktesh dhe shërbimesh për të plotësuar nevojat individuale të NjEF dhe individëve me përjashtim të blerjeve për pajisje afatgjatë, investimeve kapitale, parave për të tretët dhe qirasë së imputuar.

Grupet kryesore të konsumit janë përcaktuar sipas Klasifikimit të Konsumit Individual sipas Qëllimit (COICOP), 2012.

Periudha e referencës është kohëzgjatja së cilës i referohet një çështje e caktuar informacioni, Anketa përdor periudha të ndryshme reference në varësi të tipit të informacionit që duhet marrë dhe objektivave të secilës çështje për t'u analizuar.

Një njësi ekonomike familjare (NjEF) i referohet një grupi personash ose një personi me lidhje gjaku ose jo të cilët banojnë së bashku në një banesë dhe që ndajnë një ekonomi pjesërisht ose plotësisht të përbashkët.

Kryefamiljari është një person, që përcaktohet si i tillë për qëllimet e anketës (person që është pronar i banesës ose person i identifikuar si i tillë nga anëtarët e tjerë të NjEF). Nëse anëtarët e NjEF nuk e përcaktojnë vetë këtë person, normalisht do të jetë personi që kontribuon më shumë në të ardhurat totale të NjEF.

Fëmijë është konsideruar çdo individ nën moshën 18 vjeç.

Aneksi 1 - Klasifikimi i Konsumit Individual sipas Qëllimit (COICOP)

Klasifikimi i Konsumit Individual sipas Qëllimit (COICOP)	
KATEGORITË	Disa detaje përsa i perketzërave në çdo kategori të cilat shërbejnë vetëm për konsum familjar.
1 - USHQIME DHE PIJE JO-ALKOOLIKE	Produktet ushqimore të klasifikuara këtu janë ato të blera dhe të prodhuara për konsum në shtëpi.
	Grurë, Misër, Oriz, Miell dhe nënprodukte të tij, Bukë, Mish, Peshk, Produkte të tjera deti, Vaj, Fruta, Perime, Qumësht, Djathë, Gjalp, Gjizë, Vezë, ujë mineral dhe me gaz, lengje frutash, Kafë, Caj, Mjalt, Produkte Sheqeri, Te gjitha produktet e kesaj kategorie te prodhuara nga vete familja et
2 - PIJE ALKOOLIKE DHE DUHAN	Pijet alkoolike të klasifikuara këtu janë ato që zakonisht blihen për konsum në shtëpi.
	Verë, Birrë, Raki, Ehiskey, Të gjitha llojet e Likernave, Uzo dhe pije të tjera gjallëruese Duhan, Cigare, Puro, Letër cigare, Filtër etj.
3 - VESHJE DHE KËPUCË	Në këtë zë përfshihen veshje, këpucë, të reja apo të përdorura, materiale për veshje, dhe riparimi i tyre, etj.
	Veshje për burra, gra, fëmijë (3 deri 13 vjeç) dhe foshnja (0 deri 2 vjeç), qofshin të gatshme ose të bëra me porosi, në të gjitha materialet (përfshirë lëkure, gëzof, plastike dhe gome), të përditëshme, për sporte ose për punë: pardesy, mantele shiu, bluza, xhupa, xhaketa, pantallona, kostume, fustane, funde, etj, Këmisha, bluza, pulovra, bluza pas trupit, pantallona të shkurtra, rroba banje, tuta, kostume vrapimi, geta, etj, Jelek, të brendëshme, çorape, streçe, geta, sufiena, funde me palë, të brendëshme me tantellë, fustane nate, breza, korse, çorape të thurura, etj, Bizhama, bluza nate, robdishane, kostume banje, xhaketa për shtëpi, etj, Veshje për fëmijë dhe çorape të thurura për fëmijë.
4 - STREHIMI, UJI, ENERGJIA ELEKTRIKE DHE LËNDE TË TJERA DJEGËSE	Në këtë zë përfshihen: Qiraja e paguar (si shpenzimi i kryer efektivisht për marrjen e ambienteve të banimit me qira nga ana e NjEF), mirëmbajtja dhe riparimi i banesës, materiale për riparim, pagesa për energji elektrike: ujë, gaz, heqje plerash, dhe të gjitha pagesat që kanë lidhje me banesën e familjes etj.
5 - MOBILJE, PAJISJE PËR SHTËPINË DHE MIRËMBAJTJAE ZAKONSHME E SHTËPISË	Në këtë zë përfshihen: Krevate, sofa, divane, tavolina, karrige, bufë, komo dhe raftë librash, pajisjet e ndriçimit si abazhurë tavanesh, llampa standart, në formë globesh, dhe abazhurë komodinash, të gjitha llojet e tekstileve për shtëpi, pajisje elektroshtëpiake, pajisje dhe vegla për kopshtin, tapete, riparimi i tyre, pagesa për kopshtar, guzhiniere, dado etj.
6 - SHËNDETI	Ky grup mbulon ilaçet, protezat, makineritë dhe pajisjet mjekësore si dhe produkte të tjera të lidhura me mjekimin të blera nga individët, me dhe pa recetë, zakonisht nga furnizuesit e ilaçeve, aparatura dhe pajisje terapeutike, të gjitha llojet e shërbimeve mjekësore përfshirë dhe ato ambulatorie etj.
7 - TRANSPORTI	Të gjitha llojet e makinave, të reja dhe të përdorura, taxi, Bileta avionësh, të gjitha llojet e biletave Naftë, Gas, Pjesë këmbimi dhe riparime, Garazhde, etj.
8 - KOMUNIKIMI	Shërbime postare, të gjitha llojet e shërbimeve për komunikim, telefona, celularë, fax, internet etj.
9 - ARGËTIMI DHE KULTURA	Në këtë zë përfshihen të gjitha llojet e pajisjeve audio-vizuale, Aparate marrje, regjistrimi dhe riprodhimi të tingujve dhe filmave, Pajisjet e përpunimit të informacionit, Pajisje fotografike dhe kinematografike dhe instrumente optike, Të mira afatgjata për argëtim në ambientet e jashtme, Pajisjet kryesore për lojra dhe sport, Bileta, loja fati, riparimi dhe mirëmbajtja e tyre etj.
10 - ARSIMI	Kjo ndarje përfshin vetëm shërbimin e arsimit
	Klasifikimi i shërbimeve të arsimit bazohet në kategori të sipas niveleve të Klasifikimit Standart Ndërkombëtar të Arsimit (ISCED) të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën (UNESCO).
	Përfshihen: Arsimit parashkollor dhe fillor, Arsimit 8/9 vjeçar dhe i mesëm, Arsimit parauniversitar, Arsimit i lartë, Arsimit papërcaktuar në nivele (Kurse arsimit).
11 - RESTORANTE DHE HOTELE	Në këtë zë përfshihen: Restorante, bare dhe të tjera si këto, Shërbimet e akomodimit, menca, etj, Përfshihen: shërbime të shpërndarjes së produkteve ushqimore (ushqime, meze, pije dhe pije freskuese) të ofruara nga restorantet, kafenetë, bufetë, baret, etj, Hotele, motele, hane dhe shërbime të ngjashme akomodimi, Qendra

	pushimesh, vende për kamping, bujtina për të rinjtë dhe shërbime të ngjashme akomodimi, Shërbime të akomodimit të institucioneve të tjera.
12 – TË MIRA DHE SHËRBIME TË NDRYSHME	Në këtë zë përfshihen: Sallone bukurie dhe institucione të kujdesit personal, Pajisje elektrike dhe jo-elektrike për kujdes personal, riparimi i pajisjeve për kujdes personal, Sende personale, Përkrahja sociale, Sigurimi, Shërbime financiare të specifikuar, Shërbime të tjera të paspecifikuara etj.